



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

Nr. 203 Prot.

Tiranë më 30.05.2022

**PROCESVERBAL**

**Mbledhje e Bordit Mbiqyrës të AMShC-së**

Më datë 30.05.2022 në orën 15:30, në Ambjentet e AMSHC-së, sipas njoftimit u mbajt mbledhja e Bordit Mbiqyrës të AMShC-së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraparak ishte:

1. Paraqitja e aktiviteteve kryesore të AMSHC-së;
2. Mbi procesin e Zgjedhjes së Kryetarit të Bordit të AMSHC-së;
3. Prezantimi i prioriteteve të thirrjes propozuar nga Shoqëris Civile

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e Bordit Mbiqyrës të AMShC-së:

1. Znj. Iris Luarasi – *anëtare*
2. Z. Ylljet Alicka – *anëtar*
3. Z. Laert Kola – *anëtar*
4. Znj. Vasilika Hysi – *anëtare*
5. Z. Bashkim Muca – *anëtar*

Gjithashtu të pranishëm nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

1. Z. Andi Kananaj – *Drejtor Ekzekutiv*
2. Z. Erion Banushi – *Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve*

Fjalën e hapjes e mori Z Andi Kananaj Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile i cili pasi uroi për detyrën të pranishmëve paraqiti një kornizë të aktiviteteve kryesore të agjencisë si dhe rendin e ditës për diskutim. Ndërkaq ftoi anëtarët e bordit për të propozuar dhe votuar për Kryetarin e Bordit të AMSHC-së.

Fjalën e mori Z. Kola i cili hodhi në propozim emrin e Znj. Iris Luarasi për kryetare të bordit Mbiqyrës të AMSHC-së për shkak të eksperincës së saj të gjatë me shoqërinë Civile.

Të gjithë të pranishmit në mbledhje votuan unanimitë për zgjedhjen e Znj. Luarasi si kryetare Bordi.

Fjalën e mori Z. Kananaj i cili paraqiti për diskutim prioritet e propozuara nga SHC në konsultimin publik që AMSHC zhvilloi.

Z. Muca diskutoi pikat e propozuara në relacion. Ai sugjeroi që pikat të finalizohen si mëposhtë:

**1. Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

- Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, si edhe shërbime juridike, online;
- Mbështetje psikologjike, sensibilizuese dhe mjekësore nëpërmjet platformave online;
- Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale
- Përmirësimi i shërbimeve sociale;
- Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë;

Z. Muca shprehet se pika e dytë është detyrim strategjikë, ndaj është e pranuar.

**2. Mjedisit, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm:**

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmytjet, zjarret, tërmete etj.);
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij;
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;

**3. Arsimit dhe Integrimi European**

- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj;
- Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;
- Stimulimi dhe nxitja e të rinjve për të qënë pjesë vullnetare e OSHC-ve;
- Përfshirja shoqërisë civile në proceset e politik-berjes; përsa i takon reformave publike si dhe vendimarrjeve publike;

Fjalën e mori Znj. Vasilika sipas së cilës prioritet i duken sh të përgjithshme, propozon për të qënë më specifike dhe një ndërthurje midis tyre.

Ndërkohë Z. Kananaj shpjegon se kjo ka ndodhur duke respektuar propozimet e ShC si dhe për të qënë sa më gjithëpërfshirëse dhe për mos të kufizuar procesin e marrjes pjesë për konkurrin në thirrjen që AMSHC hap.

Z. Alicka propozon fushën e arsimit, fushën kulturore- artistike dhe i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv nëse lejohet sponsorizimi i librit, filmit?

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC- së përgjigjet se ekziston një Rregullore mbi bazën e të cilës kryhet financimi i granteve e cila nuk lejon blerjen e materialeve por ndërkohë, për pjesën e sponsorizimit të librit, mund të diskutohet vendosja ose jo e çmimit dhe duke dorëzuar pranë AMSHC- së të paktën 5 (pesë) kopje.

Znj. Hysi i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv nëse ka informacion lidhur me prioritetet që donatorët e tjerë kanë lidhur me shpalljet e tyre.

Drejtori Ekzekutiv shprehet se ia kemi kërkuar këtë informacion por nuk janë shprehur të disponueshëm për të n'a e ofruar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

z. Banushi ndërhyt dhe shprehet se ka ekzistuar Donor Coordination Meeting por është ndërprerë prej disa vjetësh.

Znj. Hysi propozon Fokusin mbi Bullizmin, Grupet vulnerabël të tilla si Down Syndrome, autik, mbështetje për zonat rurale sidomos të rinjtë e këtyre zonave për të stimuluar zhvillimin e tyre dhe të komunitetit. Gjithashtu, propozoj që fokusi të jetë drejt edhe Turizmit, Korrupsionit- si pjesë e procesit të integritit të vendit drejt BE- së me nënrubrikë, pjesën e prokurimeve fushë në të cilën është investuar dhe po punohet për të shmangur çdo formë korrupsioni, si dhe Zbatimin e ligjit dhe Transparencën e Institucioneve Publike, përfshirjen në vendimarrje të OSHC-ve Si dhe Integrimin Rajonal dhe ballkanik.

Znj. Luarasi Shprehet dakord me parafolësit, propozon fokus mbi pasojat post Covid si dhe mbështetjen e grave dhe shtresa vulnerabël, gjithashtu kërkon të shikohet qe midis pikave mos të evidentohen mbivendosje. Përsa i takon Shoqatave të reja mbështet këtë nismë të AMSHC-së për promovimin e tyre.

Z. Alicka shprehet se do duhet të vendoset fokus dhe tek Edukimi Mediatik Online, si dhe nga diskutimi i bërë vendosja e saj tek fusha e arsimit dhe Integritit European.

Z. Kananaj shpreh se mbi orientimin e dhënë prej të pranishmëve do të përpunohen prioritet e thirrjes të cilat do të dërgohen për miratimin përfundimtar anëtarëve, gjithashtu propozon shumën max 20 (njëzetë) milionë lekë për shkak të kohëzgjatjes së projekteve si dhe që të ketë mundësi të financohen sa më shumë projekte.

Së fundmi, u ra dakord që thirrja të shpallet në datën 31.05.2022.

Bashkangjitur janë dhe prioritet e vendosura nga Bordi për Thirrjen Nr. 15.

Mbledhje u mbyll rreth orës 16:15

Mbajti procesverbalin

Paula Bero

Specialist – Informimi, Publikimi, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit



## 1. Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale:

- Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID për grupet në nevojë (të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, mjekësore si edhe shërbime juridike, online;
- Rritja e kujdesit për shtresat vunerabël e ato në nevojë, autik dhe Down syndrome, të rinjtë, adoloshentët, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe të trafikimit si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (rome, egjiptjan, LGBT, etj);
- Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale;
- Përmirësimi i shërbimeve sociale si dhe mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë;

## 2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20%, 10%, 10% e fondit që do shperndahet)

Ky prioritet është në kuadër nga detyrimet që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndersektoriale Kunder Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;


- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;

## 3. Mjedisit, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm:

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.);
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit;
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij;
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe artistike përmes promovimit të librit, kinematografisë dhe artit;

## 4. Arsimi dhe Integrimi Evropian

- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj;
- Prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;



- Stimulimi dhe nxitja e të Rinjëve për të qënë pjesë Aktive;
- Përfshirja e Shoqërisë Civile në proceset e politik-berjes; përsa i takon reformave publike si dhe vendimarrjeve publike;
- Edukimi Mediatik Online;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIQYRËS

Nr. 203/1 Prot.

Tiranë më 30.05.2022

**VENDIM**

Nr. 1 Datë 30.05.2022

Bazuar në Ligjin Nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”; V. K. M- së Nr. 769, dt. 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” (I Ndryshuar) dhe Rregullores “Mbi Proçedurat e Financimit me Grante”, Bordi Mbiqyrës i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin përfundimtar të prioriteteve sipas tekstit të Procesverbalit me Nr. 203 Prot. të datës 30.05.2022 ;
2. Shuma maksimale e fondeve të dhëna do jetë 2.000.000 (Dy milionë) lekë;
3. Shpalljen e Thirrjes nr. 15 duke filluar nga data 31.05.2022 deri më 01.07.2022 ora 14:00
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Për Bordin ranë dakord Kryetari dhe anëtarët si më poshtë:

1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Për Bordin Mbikqyrës:

**Irisi Luarasi**

*Kryetare e Bordit Mbikqyrës*

**Ylljet ALIÇKA**

*Anëtar*

**Laert KOLA**

*Anëtar*

**Vasilika HYSI**

*Anëtare*

**Bashkim MUÇA**

*Anëtar*

